

AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MS Group 21” Sh.P.K.

Sot në datën 06.05.2021, ditë e enjte, Ne ortakët, themelues, si më poshtë identifikohemi:

- 1) **Z. Sajmir Kadiqi**, atësia Gëzim, i lindur më 12.06.1990, në Durrës dhe banues në Durrës, lagjja nr. 5, rr. "Kasem Durrsi", shtetas shqiptar, identifikuar në regjistrat e Gjendjes Civile me nr.personal J00612063P;
- 2) **Z. Miland Gjuzi**, atësia Naim, shtetas shqiptar, lindur në Durrës më 27.02.1994, banues në Durrës, madhor, identifikuar në regjistrat e Gjendjes Civile me nr.personal J40227081L;
- 3) **Shoqëria KLIVA Sh.P.K.**, me seli në adresën: Durrës, lagjja nr.13, Blloku i Vilave Qeveritare, Iliria Plazh, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (Q.K.R./Q.K.B.) më datë 09.02.2011, identifikuar me NUIS/NIPT L13809601Q, përfaqësuar nga administratorja nga **znj. Klarita Salillari**, atësia Gëzim, lindur më 23.08.1993 në Durrës dhe banuese Durres, lagjja nr.1, rr. "Taulantia", shtetase shqiptare, identifikuar në regjistrat e Gjendjes Civile me nr.personal J35823081S;

Hartojnë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar si më poshtë:

NENI 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet **“MS Group 21” Sh.P.K.** dhe është person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve të këtij statusi dhe ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si edhe ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim.

NENI 2

SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në do të ketë selinë e saj në Durrës, lagjja nr. 1, rr. Taulantia, nr.pasurie 27/76 - 615, vol. nr. 41, faqe nr. 137, zona kadastrale 8512. Shoqëria mund të krijojë Filiale, Zyra Përfaqësimi, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë si **objekt të veprimtarisë së saj, por duke mos u kufizuar** :

- Konsulencë menaxheriale, konsulence menaxhimi financiar, pergatitjen e planeve te biznesit, implementimin dhe zhvillimin e tyre. Rekrutim dhe sherbime burimeve njerezore. Krijimi i faqeve ëeb, platformave elektronike ne internet dhe aplikacioneve me synim zhvillimin e aktivitetit te shoqerise ne marketing edhe nepermjet pajisjeve elektronike te komunikimit ne distance.

- SHOQËRIE
RUCI
- Komisioner, Ndermjetes, Agjent Shitje, Agjent Publicitar, spote online dhe publicitete per sherbime ne fushen e mjekesise dhe shendetit per vendas dhe te huaj. Sherbime ne specialitete te ndryshme mjekesore, vizita, konsulta, kontrole mjekesore, ekzaminime etj.
 - Pjesemarrjene investime industriale dhe tregtare, si dhe ne aktivitete te ndryshme financiare, tregtare e industriale. Marrja/dhenia me qira e pasurive te paluajtshme; mund gjithashtu te kontribuojë, drejtpersedrejti ose terthorazi, por gjithmone me qellimin e vetem per arritjen e objektit te shoqerise dhe jo ne menyre dominuese, me pjesemarrje dhe interesa ne shoqerite tjera dhe kompani me objekt te njejte ose te ngjashem me te dhe mund te lidhe kredi hipotekimi dhe fondesh, vendosja e pengjeve, barreve siguruese per te siguruar huate e shoqerise ose paleve te treta. Marketing dhe shperndarja e prodhimeve te saj dhe sherbime ndaj te treteve.
 - Pjesemarrja ne shoqeri ekzistuese ose qe do te krijohen ne te ardhmen, me qellim krijimin e subjekteve ligjore, me qellim te njehta apo te ngjashme. Pjesemarrja ne prokurime publike ose private, qe lidhen me ofrimin e sherbimeve dhe te gjitha aktiviteteve te tjera te parashikuara ne objektin e kesaj shoqerie. Ne pergjithesi te gjitha aktivitetet industriale, tregtare, financiare, civile, te luajtshme ose te paluajtshme, qe mund te lidhen direkt ose indirekt me objektin e shoqerise ose me objekt te ngjashem apo te perafert. Perfaqesimin e shoqerive te ndryshme, shqiptare dhe te huaja, qe kane objekt te njejte apo te perafert me ate te kesaj shoqerie.
 - Te marre pjese ne tendera dhe gara private ose publike, ndertimi dhe restaurimi i fabrikave te te gjitha llojeve, per vete apo te trete, blerjen e tyre.
 - Tregti me shumice dhe pakice te produkteve farmaceutike, parafarmaceutike, dhe pajisje mjekesore, kozmetike ne pergjithesi, si dhe prodhimin dhe tregtimin e produkteve qe rrjedhin nga bimet medicinale.
 - Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmës që ka si qëllim ofrimin e cdo aktiviteti tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor, si dhe çdo aktivitet tjetër që konsiderohet fitimprurës dhe në interes të shoqërisë.

NENI 4 **KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë “MS Group 21” Sh.P.K., është 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në tre (3) kuota.

Pjesëmarrja e themeluesve/ortakëve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre dhe do të shpërndahet si më poshtë:

1. **Sajmir Kadiqi**, zotërues i një (1) kuote që përkon me 45 % të kapitalit themeltare, me vlerë të përgjithshme: 45.000 lekë.
2. **Miland Gjuzi**, zotërues i një (1) kuote që përkon me 45 % të kapitalit themeltare, me vlerë të përgjithshme: 45.000 lekë.
3. **Shoqëria KLIVA Sh.P.K.**, zotërues i një (1) kuote që përkon me 10 % të kapitalit themeltare, me vlerë të përgjithshme: 10.000 lekë







NENI 5
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kompania do të kryejë aktivitetet e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6
ORGANET E SHOQËRISË

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve
2. Administratorët

NENI 7
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerine për çeshtjet e mëposhtme:

1. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqerise.
2. Ndryshimin e statutit.
3. Emerimin dhe shkarkimin e administratorëve.
4. Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar.
5. Përcaktimin e shpërblimeve për administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
6. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët ,përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportve të ecurise së veprimtarisë.
7. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
8. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
9. Përfaqesimin e shoqerise në gjykate dhe në procedimet e tjara ndaj administratorëve.
10. Riorganizimi dhe prishjen e shoqerise.
11. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese.
12. Çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

NENI 8
ADMINISTRATORËT

Administratori i shoqerise do të jetë:

1. **Z. Sajmir Kadiqi**, i biri i Gëzim –it, i lindur më 12.06.1990, në Durrës dhe banues në Durrës, lagjja nr. 5, rr. "Kasem Durrsi", shtetas shqiptar, identifikuar në regjistrat e Gjendjes Civile me nr.personal J00612063P;

Administratoria emerohet për një afat pesë (5) vjeçare i cili fillon më datë 06.05.2021. Data e përfundimit të këtij afati është 05.05.2026.

Administratori mund të shkarkohet në çdo moment nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, me shumicë të thjeshtë të votave, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 % të kuotave.

Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këto të drejta.

NENI 9
SHPERNDARJA E FITIMIT VJETOR TË SHOQERISE

Pjesa e fitimit që takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendose te shperndahet nga asambleja e pergjithshme ka kopetence t'u shperndaje ortakëve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar , qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne. Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos t'u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 10

PRISHJA E SHOQERISE, LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

Prishja e shoqerise

Shoqeria priset:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) Me vendim te asamblese se pergjithshme;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) Nese nuk kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuat pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr .9723 date 03.05.2007 per "QKR";
- e) Me vendim te gjykates;
- f) Per arsye te tjera, te parashikuara ne statut.

Largimi i ortakut

Ortaku mund te largohet nga shoqeria:

1. Nese ortaket e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij;
2. Nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij;
3. Nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo per shkaqe te tjera, qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.

Perjashtimi i ortakut

Ne baze te nje vendimi te zakonshem, asambleja e pergjithshme mund t'i kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut, nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve te statutit, ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim, te parashikuara ne ligj.

NENI 11

LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likuidator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likuidimit.

Me vendimin e posaqem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve te shoqerise, likuidatori shperndan pjesen e mbetur behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat esecilit ortak perfaqesojne.

NENI 12

PERFUNDIMI I LIKUJDIMIT

Pas shperndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombetare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

NENI 13

MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim.

Ne rast te kundert, ortaket themelues do ti drejtohen Gjykates Rrethit Durrës per zgjidhje.

Ky akt themelimi nënshkruhet pa asnjë vërejtje nga themluesit.

ORTAKET
e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "MS Group 21" Sh.P.K.,,

1. **Sajmir Kadiqi,**

Sajmir Kadiqi

2. **Milend Gjuzi**

Milend Gjuzi

3. **Shoqëria KLIVA Sh.P.K. përfaqësuar nga administratori Klarita Salillari**

KLARITA SALILLARI

